

UDC 005.32

Ardian Ramadani, MA⁵¹

КОНА ПËР ЛИДЕР(SHIP) СИЛËСОР

ВРЕМЕ ЗА КВАЛИТЕТЕН ЛИДЕР(ШИП)

**LEADER OR LEADERSHIP - THE CHARACTERISTICS OF A
MODERN LEADER (SHIP)**

Abstract

It is certainly true that the key of leading one population towards rivers of success is the leader and its leadership. Therefore, in this paper are presented the characteristics of a modern leader (leadership). Which are the distinctive elements that a leader must implement in order to be consecutive and pursued by the successor. Why today is not any more the time of a single leaders, to those whom we built cults of individuals, as well as why it is imperative and necessity the establishment and formation of a ruling elites, who have team spirit, who are ready to work in a team, and not solely .

The question is, how is distinguished one man as a leader, what are its characteristics, which things excels him as a leader, which are those characteristics that pose and expose a man as a leader? There are many things that I will try to analyze them in a concise form.

⁵¹ Përkthyes, profesor i gjuhës dhe letërsisë frënge, magjistër i diplomacisë dhe shkencave politike, si dhe opinionist dhe kolumnist.

There will be analyzed different types of leaders and leaderships, then also must be highlighted types of these leaders, which means to unfold and categorize each of them separately.

In the troublous Balkan which goes to be relaxed and rehabilitated properly, even that the trends of some leaders that through nationalist policies are trying to keep the crowds under control and lead the processes behind, it is important to note that the leaders who use nationalism, populism, populist rhetoric, the politics of force, the means of pressure and oppression, the imposition of opinions and decisions are going toward marginalization from the international factor and the factor time, fortunately, because the current circumstances and the actual times do not allow patriarchal and nationalist mentality from the second world war. This does not mean that the leader should become cosmopolitan and completely forget the national interest, but above all he need to take into account the human interest and then that rational. Mediocrity is not appropriate for the leader and the current leadership.

A leader who will be stamped as a suitable and accepted leader shouldn't have the revenge in its soul and politics, but on the contrary, with not hating and despising the others, he should be shown as a measured who knows to wait. The leader who will reach the equilibration or balance between the militants and the hot crowds and power is the type of leader who is needed today in this time of "Knowledge Society", because the interests of both parties are warring and often contradictory.

Authentic leader, in cooperation with the team need to serve to the motherland at any time, in any regime, in any situation. But he needs to know how to do it. For the end, the saying: "You can't build a house with or in one pillar", should be a guideline for the leader, for as much as state, i.e. the power is not led by one man, but by a team.

This must be respected and taken into consideration by the contemporary leader.

1. Vështrim i përgjithshëm

Çelësi kyç i udhëheqjes së një populli drejt mirëqenies është qeverisja e mirë. Qeverisja e mirë nga elitat qeverisëse dhe nga shtetarë të suksesshëm. Nga ajo që njihet rëndom me emrin lider dhe lidërsip. Nga forma e qeverisjes dhe nga sistemi politik i aplikueshëm në atë shtet-komb. Formësimi i elitave politike që do të shprijnë në mirëqenie dhe mirësi popullin, shtetin-komb është njëra nga detyrat më të vështira sot, ka qenë edhe dje, e me gjasa do të jetë edhe në të ardhmen. Është një sfidë shkuar sfide.

Aktualisht në epokën e sotshme, elitat politike qeverisëse në Ballkan, me gjithë se ende janë në thelb lidërsipe tradicionaliste që dolën nga doktrinën dhe lëvizjet masive populiste të tipit turbo-folk, në saje të mjedisit politik që i prodhoi ato, ngelën brenda vorbullës së tyre, duke mos mundur të ngrihen dot në nivelin e elitave të larta, moderne dhe cilësore euroatlantike. Koha po dëshmon se ato elita nëse mund të quhen ashtu nuk po mund të shohin më larg sesa interesat dhe emocionet e grumbullimeve që i sjellin në pushtet. Ato duke mos mundur që të veprojnë konform interesave afatgjata dhe vizioneve për të ardhmen po veprojnë nën presionin e nevojave dhe kërkesave imediate afatshkurtra që kërkon lëvizja politike e shoqërore që i krijon ato. Me një portret reminishent të së kaluarës, ato po dëshmojnë se nuk janë projektion i së ardhmes. Me një mungesë qartësie, konsistence dhe vizioni.

Lidërsipi aktual në Ballkan i karakterizuar nga një etikë shumë e dobët, në mungesë të një etike qytetare, moderne dhe demokratike, si pasojë e të kaluarës komuniste, por edhe e formëimit të tyre në mjedise jo demokratike, janë të përcjellë me një mënyrë autarkike, autokratike dhe imponuese, jopranuese dhe gjithëpërfshirëse, të përcjella me emocione turmash, pa arsytim dhe racionalitet, të dominuara nga edukata e rrugës dhe zhargoni i rëndomtë, nga morali i shpifjes dhe shpifjet pa moral, duke shfaqur një performancë marrëdhënies, komunikimi njerëzor, shoqëror, politik, kombëtar

dhe ndërkombëtar të karakterizuara nga intoleranca dhe standardet e dyfishta ndaj faktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë.

Për të ndryshuar këtë imazh nevojitet lidershipe të sigurojnë kalimin nga politika e forcës në forcën e politikës, që do të pranojnë pranimin në vend të imponimit, racionalitetin në vend të emotivitetit, përfshirjen në vend të përjashtimit, diversitetin e jo rrafshimin, kohezionin e jo divergjencat, kompromisin e jo detyrimin, konsensusin e jo njëanshmërinë, integrimin e jo izolimin.

Meqenëse lidershipi është përgjegjësi kryesor për qeverisjen e pushtetit, atëherë me të drejtë pushtetin mund ta definojmë si marrëdhënie mes njerëzve të caktuar.⁵² Është tejet thelbësore në konceptin e pushtetit roli i qëllimit. Si dhe mënyra për arritjen e të njëjtit.

Varësisht nga modelet e përfaqësimit, ai i mirëbesimit (Burke), modeli i delegimit, mandatimit apo përngjasimit (Paine), lidershipi duhet të udhëheqë pa ankth dhe nxitim. E sot lidershipi në Ballkan kanë shumë ankth dhe nxitim.

2. Cilësitë dhe karakteristikat e liderit vis-à-vis të qeverisurve

Shtrohet pyetja se si dallohet një njeri si lider, cilat janë karakteristikat e tij, me çfarë gjëra shquhet ai si lider, cilat janë ato karakteristika që e paraqesin dhe e eksponojnë një njeri si lider?

Për ti shkoqitur këto gjëra, duhet pasur parasysh dhe duhet bërë ndarje mes liderit në një shtet demokratik dhe atij në një shtet me demokraci të brishtë, neodiktatoriale, me sisteme të korrupuara joefiçiente, me mungesë të kulturës dhe përvojës demokratike.

Është më se e qartë se pushteti është mjaft i lidhur me liderin dhe e kundërta, lideri është i lidhur për pushtetin. Pushteti dhe lideri apo lidershipi maten me sasinë e prodhimit të ideve ndaj efekteve të paparashikuara. Dhe kjo ndodh jo vetëm në formën teorike, por edhe në formën praktike.

⁵² Boriçi, Gjon "Pushteti dhe lidershipi", f. 22, Tiranë, Geer 2007.

Karakteristikat e një lloji të liderit demokratik, të një njeriu i cili nuk vuan nga sëmundja kancerogjene e kultit të individit, të një njeriu i cili nuk vuan për mbështetjen qind për qind nga masat e thjeshta, sepse është koshient që nuk mund të ketë përkrahjen qind për qind nga masat, sepse kjo në një mjedis demokratik është e pamundur.

Nëse flasim në bazë të digresioni të bërë më parë që ekzistojnë tipa të ndryshëm të liderëve dhe lidershipit, atëherë duhet patjetër të potencohen edhe tipat e këtyre liderëve, që do të thotë të shpalo-sen dhe shkoqiten secili veç e veç.

Por, një gjë dihet, ata që janë të arsyeshëm dhe racional e pranojnë gjykimin dhe vlerësimin, si dhe njëkohësisht edhe realitetin që koha e liderëve historik tradicional sasior në Ballkan duhet përfunduar, si dhe ata duhet të jenë pjesë e historisë dhe mendësisë së shekullit që lamë pas. Mirëpo, edhe pse në doza të caktuara mund të hasim edhe më tutje liderë të llojit demodé, të shekullit të kaluar, ata liderë duhet të izoloohen që mos tu jepet mundësia që të tregojnë veten e tyre, të promovohen si dhe të keqpërdorin masën e njerëzve. Ata që nuk pajtohen me këtë realitet objektiv janë pesimistë subjektiv dhe të verbër politikisht.

Në Ballkanin e trazuar me gjithë tendencat e ca liderëve që përmes politikave nacionaliste të mbajnë turmat nën kontroll dhe të shpijnë proceset prapa, është me rëndësi të thuhet që liderët që përdorin nacionalizmin, popullizmin, retorikën demagogjike, politikën e forcës, mjetet e presionit dhe shtypjes, imponimin e mendimeve dhe vendimeve... ata njëkohësisht po shkojnë edhe drejt marginalizimit edhe nga faktori ndërkombëtar edhe nga faktori kohë fatmirësisht, sepse rrethanat dhe kohërat aktuale nuk lejojnë mendësinë patriarkale dhe nacionaliste të para dy luftërave botërore. Kjo nuk do të thotë që lideri duhet të bëhet kozmopolit dhe të harrojë krejtësisht interesin kombëtar, por ai duhet të ketë parasysh interesin njerëzor mbi të gjitha e mandej edhe atë racional. Mediokriteti për liderin dhe lidershipin aktual nuk mund të shkojë.

Me gjithë fatkeqësinë që kemi pasur si njerëz, si gjenerata që të jemi peng i liderëve që janë të kompozuar nga mendësia e të qenit superior ndaj gjithçkaje, duke abuzuar me masat, koha aktuale rrethanat që na kanë sjellë impaktin e theksuar të globalizimit, të kibernetizimit, të një miksi jashtëzakonisht të madh dhe të theksuar të gjërave që më përpara ishin utopi për liderët e atëhershëm, na detyrojnë patjetër që të mendojmë si duhet, të sillemi si liderë dhe lidërsip politik, intelektual dhe diplomatik, si një ansambël dhe tërësi pjesë e procesit demokratik dhe integruës.

Koha e liderit kult ka mbaruar. Ata që mëtojnë të sillen dhe të luajnë me këtë kartë janë të prirë që të vdesin politikisht dhe intelektualisht. Rasti i të tillëve është numëroz. Kemi me qindra e qindra. Mirëpo ata janë pjesë e historisë së shëmtuar, ndërkaq ata që sillen si lider po që respektojnë lidërsipin, pra që punojnë në ekip, që konsultohen për çdo vendim me këshilltarë profesionistë, që pranë vetes kanë kuadro profesionale, që respektojnë alteritetin, që krijojnë tampon zona mes nacionalizmit negativ dhe patriotizmit nationalist pozitiv, ata janë te prirë që të jenë të suksesshëm dhe të kenë harmoni gjatë qeverisjes së tyre me masat popullore.

Lideri nationalist, demagog, mediokër, hipokrit që manipulon me masat, i përket historisë së shëmtuar, ndërsa ai që respekton masat, që është transparent, që respekton mendimin ndryshe, i përket liderit tipik për rrethanat aktuale dhe rrethanat që kushtëzojnë të ardhmen. Koha e liderëve pushtet (Shteti jam unë do të thoshte Luigji i XIV), është histori, ndërsa tani flet koha e liderëve që janë pushtet i institucionit dhe kjo duhet të jetë karakteristikë për këta liderë, koha e liderëve autokratik është e përfunduar, autokracizmi si formë e qeverisjes i takon plejadës së njerëzve që kanë hyrë në histori për të keq, përkundrazi koha e liderëve të rinj dhe modern sjell liderin apo lidërsipin demokratik, pranues e jo imponues, tolerant dhe elitar, e joautoritarist dhe mediokër.

Në Afrikë, në Ballkan dhe në vendet ku ka destabilitete, frus-trime dhe probleme të natyrave të ndryshme, hasen liderë me sëmundjen e pashëruar të liderizmit që nënkupton, që njerëz të

rëndomtë bëhen politikanë brenda natës, partiakë dhe militantë mediokër bëhen ministra, zëvendësministra, popullistë të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, liderë provincialistë dhe krahinor, bajraktarë të fiseve primitive bëhen figura udhëheqëse, e tërë kjo ndodh si pasojë dhe reperkusion i totalitarizmave të llojit sui generis, që janë relikte të së kaluarës, por që pengojnë edhe të tanishmen, në rrugën drejt të ardhmes.

Lufta kryesore mes liderit modern që e shoqëron gjithashtu edhe karakteristika e guximit, krenarisë, si dhe vlerave të tjera të lartpërmendura, si dhe atij lideri tradicional, mund të definohet në luftën vlerë-antivlerë. Në Evropë për shembull, e më konkretisht në shtetet që kanë demokraci të konsoliduar dhe shoqëri të hapur ku vlen mendimi kritik dhe ai kreativ, konkurrenca nuk bëhet në mes këtyre dy lloje të modeleve të liderëve, po zhvillohet konkurrencë dhe garë në frymën vlerë- vlerë, ngase shoqëria e konsoliduar i ka në harresë reликтet e liderëve antivlerë. Konkurrenca e vlerave sjell përparim. Ndërsa lufta vlerë antivlerë nuk është kaherë përfituese për të parin, ngase ky i dyti i instaluar institucionalisht dhe i veshur me petkun demokratik, sfidon të parin. Nuk është asgjë rrëzimi i diktatorëve, sa është rigjallërimi i tyre dhe transferimi i tyre në formën e demokracisë ose në fytyrën e saj.⁵³

Lideri dhe lidërshipi nuk duhet të bëhen peng i idesë, po duhet të ndjekin kohën dhe tempon e zhvillimeve, në mënyrë që sa më shpejtë të ikë koha, ai të ngarendë pas saj. Kur një lider kritikohet apo vlerësohet mëson t`i vlerësojë si duhet situatat dhe rrethanat politike, kur ndesh në fatkeqësi ai mëson të vërtetat e botës reale dhe objektive.

Lideri duhet të mësojë që edhe të japë dorëheqjen në momentin e duhur e jo të bëhet peng i karriges dhe i fronit, ngase dorëheqja është virtyt që lartëson një politikan, me kusht që ajo dorëheqje të jetë në çastin e duhur në mënyrë që të aprovohet nga elektorati dhe populli si meritë dhe si vlerë. Në politikë, ashti si edhe në gjitha

⁵³ Polovina, Ylli "Nano dhe Berisha", fq. 7, Tiranë, Progresi, 1996.

fushat tjera asnjë nuk është *eternelle*, i përjetshëm, por veprat dhe idetë që i len pas janë të tilla.

Lideri dhe lidershipi i duhur duhet të vlerësojë atë që i përsh-tatet së drejtës e më pas ajo çka është e drejtë, pra të kihet parasysh siç thoshte Kardinali Rishelje, ish-udhëheqës i Francës, respektivisht kryeministër, i cili solli impakte të fuqishme epokale, pra në politikë për të qenë lider duhet të vihet në rend të parë intelekti, arsyeja, nacionaliteti e më pas moralja.

Lideri që do të vuloset si lider i përshtatshëm dhe i pranuar nuk duhet të ketë revanshin pjesë të shpirtit të tij dhe politikës, por përkundrazi duke mos urryer dhe duke përbuzur tjetrin, ai duhet të tregohet jo i nxituar, por i matur të dijë të presë. Lideri që do të arrijë të bëjë ekuilibrimin apo balancën mes militantëve apo turmave të nxehta dhe pushtetit është lloji i liderit që nevojitet sot në këtë kohë.

Thënia: *“Nuk mbahet shtëpia me apo në një shtyllë”*, duhet të jetë udhërrëfyese për liderin, ngase edhe shteti, respektivisht pushteti nuk mbahet me një njeri, po me ekip. Kjo duhet të respektohet dhe pasur parasysh nga lideri bashkëkohor.

E qartë besoj të jetë, pra nuk është koha për liderë njësh, po për lidership.

3. Si shpërfaqet dhe performon lideri ballkanas

Lideri ballkanas sot shfaqet sikurse personazhi i nënprefektit tek filmi “Koncert në vitin 1936”. Një burrë i majmur, i kënaqur deri në plogështi me jetën që bën dhe po aq i ngopur me autoritetin që i jep pasuria, ligji, forca dhe mjerimi i të tjerëve. Ai e nis ditën njëlloj, pavarësisht se çka ndodh rreth tij, e mbaron duke llototitur të njëjtat thashetheme. Gjatë ditës ai ka marrë aq vendim, sipas tij të rëndësishme për fatin e shumë personave të varfër apo të mjerë, për të cilët ai mendon se nuk do të ishin më të varfër dhe më të mjerë, po të mos ishte ai.

Pra udhëheqësi aktual është një e mesme e feudalëve orientalë të përzier me borgjezët e rinj kapitalistë.⁵⁴

4. Joshja e liderëve nga kulti i individit

Lufta si fjalë është hyrje në histori si lëndë.⁵⁵ Lufta varësisht se ashtë për pushtet apo jo ka rregulla që duhen ndjekur. Rregulla dhe lojëra që duhen respektuar dhe lozur. Rregullat në lidhshpet në brishta nënkuptojnë joshjen për krijim të kulteve të individit. Apo të asaj që njihet *deus ex machina*. Liderë që e mendojnë vetën në Zotë të zbritur me një mekanizëm, si një hyjni në skenë për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve. Sot këta tipa të liderëve i kemi të pranishëm gjetiu. Duke filluar me Putinin rus, e deri tek shtetarët ballkanas, përjashto Shqipërinë aktuale. Kjo formë e udhëheqjes është model se si (de)faktorizohet populli nga lidhshpeti, me votat e demosit. Pra si defaktorizohet demosi, kështoj i bjen. Defaktorizohet demosi, duke u llogaritur si makinë zgjedhëore, vetëm për interesa meskine, ndërsa lideri shpërfaqet si mesia, që do ta faktorizojë popullin e defaktorizuar, me ndihmën e ekipit me të cilin sundon, i cili ekip për të siguruar jetëgjatësinë në pushtet thur elozhe liderit, që ky lider të performojë *eternellement* (përjetësisht), duke iu ndërtuar kulti i individit. Një lider mund të na duket në pamje « demokrat » dhe në fjalor të tij bile shkua demokrat. Mirëpo mos të harrojmë, Zhan Pol Sartëri e quante De Golin « Hitler » vetëm e vetëm për shkak të autoritarizmit të tij, andaj edhe sot lideri i politikbërjes në Ballkan, në Lindje dhe në Afrikë, kudo që gjendet, vepron po në stilin e njëjtë dhe në performimin e njëjtë me atë të një diktatori, duke përdorur autoritarizmin e tij në çdo cep të veprimit politik, por njëkohësisht duke e justifikuar këtë nën emrin e demokracisë. Duke aluduar në thënien e Madame De Stalit se « në Francë liria është traditë, e despotizmi aktual » për epokën e De Golit, me gojën plot mund të

⁵⁴ Blushi, Ben “Hëna e Shqipërisë”, f. 35, Tiranë, UETPRESS, 2014.

⁵⁵ Surroi, Veton “Libri i fluturave”, f. 37, Prishtinë, Koha, 2011.

thuhet se aktualisht në Ballkan, dhe në shtetet e brishta afrikane vlen thënia ime « Despotizmi është traditë, e liria e diktaturës aktuale ».

Ponc Pilati në emër të perandorisë së vet, donte të vinte rregull, por ai nuk kuptonte se idetë nuk ndahen, as nuk mposhten, as nuk vdesin e as nuk zhduken. Në vazhden e thurjes së planeve të tija, me net të gjata pa gjumë ai në kllapi shihte veten të glorifikuar, i bëhej sikur në pallatin e tij e rrethonte turma e madhe njerëzore, që e thërriste thekshëm : Pilat..... Pilat Pilat

E njëjta përshtypje është duke i ndodhur sot liderit dhe lidershipit ballkanas. Duke i thurur aureolë lavdie nga sejmenët dhe shërbëtorët, e besa edhe nga intelektualët e brishtë. Po pse pikërisht këta të fundit? Sepse me gjasa intelektualit si term francez i shek 19, nuk po bëhet bartës dhe propagandues i arsyes dhe moralit njerëzor (BAUMAN), nuk po prodhon ide të pakontekstualizuara, të vlefshme në secilën kohë (COLLINS), nuk po ndjehet i mërguar brenda shoqërisë, nuk po ngjan të jetë i panënshtuar ndaj kultit të individit dhe Njëshit të politikës (SAID), si dhe i mungon guximi dhe fantazia të flasë publikisht (HABERMAS).

Me gjasa Dimitri Volkognov kishte të drejtë kur shprehej se « Nuk ishte vetëm diktatori që bënte të ekzistonte sistemi, por edhe sistemi që krijonte diktatorin ». Andaj ky sistem që krijon edhe më tutje këtë(a) neodiktatorë(a) nuk bëhet pa kontributin dhe votën tonë, pa legjitimitetin tonë. Sepse edhe komunizmi dje, e edhe fytyra e tij sot nën emrin e demokracisë, është një tmerr i vërtetë i përcjellë nga njerëz të devotshëm, si dhe i legalizuar po nga ne.

Rreziku apo e keqja e popullit as nuk ka ardhur e as nuk vjen nga përqendrimi i pushtetit por nga shpërdorimi i tij, nën emrin e demokracisë, e me performimin e Njëshit. Njëshit si shtetar dhe politikbërës, e jo Njëshit, Atij që na krijoi dhe na dha mundësi të flasim, frymojmë, dëgjojmë....., pra Zoti.

Flasim për një shoqëri të civilizuar, e këndeje Teoritë e njëshit edhe më tutje na kërcënojnë, urdhrat e tij (tyre) janë të paçenueshëm(me) dhe të paprekshëm(me), thuaja se ai(ata) është (janë) i (të) dërguari(ët) i (e) Zotit në tokë, për të na shpëtuar. Përmendim

modelin amerikan dhe evropian, e harrojmë se modeli amerikan i një shoqërie të civilizuar është ajo me pesë pushtete të forta : Presidenti, kongresi, gjykatat, media e shkruar, televizioni. Ku i kemi ne këto të fundit, përpos të parës ? Në nivelin e pakënaqshëm dhe tmerrësisht të dobët. Flasin për të majtën, për të djathtën, e nuk kemi lidhje me origjinën e tyre, as me veprimin e tyre, e as me profilin e tyre, ngase gjithçka është nebulozë dhe e paqartë, e bile as vet Njëshat nuk dinë se a janë të djathtë apo të majtë, kur flasin se janë të majtë e kanë mendjen në të djathtë, e anasjelltas.

Andaj për të dalë nga ky rreth vicioz, për të krijuar elita qeverisëse dhe lidership efikas duhet të njerëzohet politika përmes pjesëmarrjes së intelektualëve në të (V. Havel). Ndërsa njeriun e ideologjizuar duhet ta shpëtojmë sa më parë, edhe atë ose ta ideologjizojmë përmes mëkëmbjes së një shoqërie të hapur, moderne, të lirë ose ta deideologjizojmë në mënyrë false, pra t`i heqim njërën ideologji e ti vendojmë një tjetër.

Mos të harrojmë se sensi i politikës është liria (Hannah Arendt) e jo kulti i individit. Andaj nëse flasin për demokracinë e vërtetë, duhet ta mundim korrupsionin dhe ndotjen e secilës pore të jetës shoqërore, ose ta korruptojmë edhe më tej demokracinë. Ngase opozita e diktaturës dhe komunizmit nuk është antikomunizmi, i cili shpesh herë i ngjan komunizmit, por është toleranca, respektimi i ligjit dhe demokracia.

Unë, ti, ai, ajo, të gjithë duhet ose të pranojmë politikën e përgjegjësive dhe t`i ftojme Njëshat tonë në këtë drejtim, ose të pranojmë politikën e bindjes absolute të Weberit dhe do të jemi me gjasa tufa, e besa edhe në ndjekës të verbër.

E gjithë kjo do të ndikojë që kultit të individit dhe Njëshit, o ti jap kartonin e kuq e të hap rrugën për demokracinë e vërtetë, por jo me fytyrë neokomuniste, ose ne do të marrim kartonin e kuq e do të bëhemi ndërtuesit e devotshëm dhe kontribuuesit e krijimit të aureolës së lavdisë së Njëshit dhe kultit të individit, si dhe do të zgjasim robërinë dhe varësinë tonë. Politikani dhe shtetari që na udhëheq nën emrin tonë dalëngadalë do të vijë te thënia e Ponc

Pilatit: « Ndoshta edhe ne jemi fajtorë se u besojmë shumë të vërtetave tona dhe nuk i dëgjojmë të vërtetat e të tjerëve ». Por, që të ndodhë një gjë e tillë duhet që intelektual, studiuesi, shkrimtari, mësuesi, nxënësi, studenti, ... të thotë « J` ACCUSE » (Unë akuzoj), sikurse Emilie Zola. E ta thotë këtë hapur dhe pa mëdyshje.

5. Inaptokracia, ohlokracia dhe kakistokracia, model i qeverisjes së lidërsipit të brishtë

Inaptokracia është sistem qeverisjeje, ku më pak të aftit për të qeverisur janë zgjedhur nga më pak të aftët për të prodhuar, ndërsa anëtarët e tjerë të shoqërisë më pak të aftë ose të paaftë, për të përballuar jetën, rikompensohen ose mbështeten me mallra e shërbime të paguara nga konfiskimi i pasurisë së një numri gjithnjë e më të vogël prodhuesish..... Vet termi inaptokraci nënkupton (INAPTE-jokompetent, pa kapacitetin e duhur dhe KRATOS- autoritet apo fuqi). Është term që vjen nga frëngjishtja e përdorur nga akademiku, gazetari dhe intelektual i shquar francez Jean d`Ormesson, i ripërdorur si koncept më 2011 nga politikani anglez Paul Flynn.⁵⁶

Ky tip i drejtuesve në mes tjerash është i prirë që në emër të popullit të zaptojë tërë porët e jetës. Koha e këtij grupi të shtetarëve është e ndalur. Ata mendojnë vetëm për të sotshmen dhe të djeshmen, e jo për të ardhmen. Po pse ky soj i lidërsipit është prezent dhe cenon demokracinë. Ngase janë të paaftë, e në saje të paaftësisë së tyre paaftësojnë edhe qenësimin e demokracisë, paaftësojnë shpirtrat e njerëzve dhe paaftësojnë elitat intelektuale, duke i joshur me marginalizim, që këta të fundit të vuajnë për kafshatën e gojës, që më pas të joshin të njëjtit me ndonjë joshje sa për të qetësuar zërin kritik. Duke i shndërruar në servil. Servil i cili shpërfaqet më pas si krudhër për ata lartë e çekan për ata poshtë (Marks). Edhe pse politika synon që të krijojë njeriun e dëgjueshëm (E. From), kjo nuk

⁵⁶<http://www.wikiberal.org/wiki/Inaptocratie>

nënkupton që lidershipi të udhëheqë me qeniet njerëzore njësoj si me kopetë. Sepse lidershipi nuk ka të bëjë doemos vetëm me pushtetin, krejt kjo ngase ai është në njëfarë forme opiniononi, ndikimi dhe revolucioni nga i cili rrjedh aftësia për të drejtuar dhe për të marrë vendime. Lidershipi është një element i transformueshëm prej natyrës njerëzore. Lidershipi duhet të jetë i moralshëm. Ai duket se është i tillë vetëm kur udhëhiqet nga detyrime humane dhe nga motivimi për të qenë humn ndaj qëllimeve të fiksuara nga vet ai. Udhëheqësi lider duhet të jetë i kulturuar, të jetë sugjestionues dhe i kuptueshëm në mendimet që ai shpreh përmes oratorisë tek turma. Ky tip i lidershipit konsiston në të pasurit sa më shumë besim të vërtetë tek pasuesit dhe duke mos zhgënjyer pritshmëritë. Të pasurit moral nuk do të thotë të tregohesh i dobët, por i arsyeshëm. Qoftë edhe në HINTERLAND (humbëtirë). Qoftë edhe në mjedis mitoman. Mjedis ku refuzohet patologjikisht logjika si dhe të vërtetat e thjeshta të jetës. Ky mjedis ka nevojë për një force tranquille (forcë që sjell qetësi).

Ndërsa filozofi Jaspers, në një rast shprehet se « liria e individit është e mundur vetëm kur ajo ekziston në të njëjtën kohë me lirinë e të tjerëve.. Liria kur i jepet papritmas një populli, që nuk është i përgatitur për një gjë të tillë, nëpërmjet vet edukimit, mund të kalojë në Ohlokraci (pushtet të turmës) dhe të përfundojë në tirani, sepse bën që pushteti të bjerë në duart e një klike, e cila del ngaqë populli nuk e din se për kë po voton...

Aktualisht Ballkani dhe shoqëritë tona janë pjesë e kësaj ohlokracie. Shoqëritë tona të papjekura ende për një mjedis demokratik, ende pjesë e tranzicionit (tranzicioni periudhë që gëlltit fate), janë shndërruar në turma, duke zvetënuar konceptin e demokracisë dhe duke mundësuar një kaste politike të jetë vazhdimisht sunduese. Kjo është një metastazë e cila është tejet e rrezikshme për qenësim të demokracisë. Hermeneutika e liderizmit është sfidë edhe për vetë protagonistët e liderizmit. Por kjo hermeneutikë e liderizmit, nëse është e maturuar dhe e kulturuar me gjasa shndërrohet në sukses.

Kur jemi te kakistokracia, ajo definohet si sundim i së keqes. Është e lidhur edhe me neokracinë, sundimin e njëshit dhe lidhjeve të tij. Nëse koncentrohet i tërë pushteti në një, kjo prodhon kakistokracinë. Paj, si mund të mos themi se nuk kemi kakistokraci, me këtë lidhshmëri, i cili mbjell nacionalizëm shterp të tipit turbo folk, varfëri, korrupsion zhvatje, shtrëngim të opinionit publik, mbyllje medimeve, ... Jo rastësisht nuk jemi në lista të para në raporte të ndryshme ndërkombëtare, qoftë për korrupsion, qoftë për mungesë lirie, qoftë për varfëri.

6. Përfundim

Në shtetet moderne demokratike, lideri nuk fetishizohet, por nuk fetishizohet dhe shenjtërohet as pushteti, e as shteti. Shoqëria moderne nuk pranon shenjtërim të liderëve. Ngase edhe Karl Popper thotë se adhurimi i fuqisë politike është një prej idhujtarive më të shëmtuara njerëzore, është kujtim i kafazit dhe i nënshtrimit të njeriut. Shenjtërimi i liderëve dhe pushtetit shpie deri në oligarki, e cila është më e dëmshme se tirania (Platoni). Që të evitohet ky rrezik, duhet të promovohet dhe ruhet e drejta. Pa të drejtën shteti bëhet një bandë brigandësh (Shën Augustini).

Liderët e sotshëm duhet përjashtuar fearmongeringun (nxitjen e frikës përmes mashtrimit e kërcënimit). Ata nuk duhen të jenë përhapës të gënjeshtreve, trillues të fakteve dhe fshehës të së vërtetës. Gënjeshttra është perversitet në demokraci (Mersheimer).

Liderët dhe lidhshmëria nuk duhet të shohin qeverisjen në formën dhe variantin e Carl Schmitit, të shohin artin e qeverisjes në aksin logjik mik-armik. Lidhshmëria dhe lideri nuk duhet të futet në purpur (të behët më i rëndësishëm nga ç'është).

Lideri i sotshëm nuk duhet të bjerë në kurthin e 4 idoleve: Don Kishotit (idealizmi i tepruar), Çajlld Harolldit (dëshpërim i tmerrshëm), Titonit (ndjenja të shfrenuara) dhe pas Gilgameshit (idealizëm i tepruar).

Lidershipi dhe pushteti shihen më shumë se asnjëherë si mjete të thjeshta pune me të cilat mund të përfitohen privilegje pa u lodhur. Ata i hyjnë karrierës politike pa pasur një bagazh të përshatshëm për këtë profesion. Virtyti i të qenurit në pushtet është një gjë që shumë pak veta e meritojnë. E meritojnë ata që kanë profesionalizëm serioz për të qenë më bindës ndaj të tjerëve. Ata që ekuilibrojnë çështjet në marrëdhëniet e para me këtë profesion. Ata që nuk mësohen me karrigen e udhëheqësit, por kalojnë një proces të gjatë përgatitor tek çdo rreth shoqëror. Politika e udhëheqjes nuk është punë me « mik ». Por punë me vlera që janë të patjetërsueshme. Të cilat janë në kompeticion të vazhdueshëm. Në këtë garë fitojnë ata që i mbijetojnë këtij sistemi të pamëshirshëm. Suksesi i liderit qëndron në tërheqjen individuale dhe shmangien e egos e në nxjerrjen në pah të punës në grup. Ai duhet si pjesë e grupit apo ekipit të vihet në dukje nga të tjerët falë punës dhe zellit. Për një lider(ship) të mençur politika është vlerësim, prestigj, reputacion dhe admirim. Këto vlera nuk gjenden në politikë, por sillen aty.

Lider(shipi) është produkt i ambicieve personale, ndikimeve sociale, motivimeve politike, aftësive punuese, mundësisë për karrierë profesionale. Këto forca i japin formë dhe kuptim politikanit në ngjitje dhe e bëjnë ndikues tek të tjerët. Lider(shipi) është i farkëtuar mes ambicies dhe mundësisë për të krijuar e jo dëshirës për ta pasur.⁵⁷

Kjo *Mise en scene* duhet të jetë lajtmotiv dhe udhërrëfyes për lider(shipin). Koha e liderëve njësh mbaroi. Tani është koha e liderit në ekip. Apo e lidershipit.

7. Literatura e shfrytëzuar

1. Boriçi, Gjon “Pushteti dhe lidershipi”, Tiranë, Geer 2007
2. Polovina, Ylli “Nano dhe Berisha”, Tiranë, Progresi, 1996
3. Blushi, Ben “Hëna e Shqipërisë”, Tiranë, UETPRESS, 2014
4. Surroi, Veton “Libri i fluturave”, , Koha, 2011
5. <http://www.wikiberal.org/wiki/Inaptocratie>

⁵⁷ Boriçi, Gjon, Op. cit, f. 43,